



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të neneve 11 dhe 12.2 shkronja d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 4 paragrafi 1.9 dhe nenin 15 të Udhëzimit Administrativ nr.27/2012 MPB - 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, dhe nenet 14 dhe 15 paragrafi 2.4 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas Shkresës / E-mailit të FSK të datës 12.06.2023 (për zëvendësimin e anëtarit të FSK-së në KKSBB-në në Podujevë), Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 03 korrik 2023 vazhdim i mbledhjes së datës 29 qershor 2023, mori këtë:

### VENDIM PËR ZËVENDËSIMIN E NJË ANËTARI TË KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI - KKSBB

#### Neni 1

1. Me këtë vendim bëhet zëvendësimi i një anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, dhe atë:

**z.Edolind Vishaj**, nga Forca e Sigurisë së Kosovës – FSK në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi - Podujevë,  
zëvendësohet nga,

**znj.Illirianë Bunjaku**, e nominuar nga FSK për anëtar në Këshillin Komunal për Siguri në Bashkësi - Podujevë.

2. Zëvendësimi i përfaqësuesit nga radhët e FSK-së, bëhet konform Udhëzimit Administrativ në fuqi, dhe atë në kërkesë dhe nominim të FSK-së.

#### Neni 2

Vendimi është pjesë përbërëse e Vendimit për themelimin dhe përbërjen e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi nr.prot.01-016/01-0030693/22 i datës 29 prill 2022.

#### Neni 3

Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Pushtetit Lokal si dhe 7 dit pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 9 paragrafi 8 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, me plotësim ndryshimet e bëra me Rregulloren nr.06/2021.

Nr.Prot. 01-016/01-0045371/23  
Podujevë, datë: 03 korrik 2023

